



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.331, datë 19.12.2022

PËR
“FILLIMIN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATIT PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT
NËPËRMJET LËVIZJES PARALELE PËR NJË VEND VAKANT NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 15 pika 1 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Fillimin e verifikimit të kandidatit Gazmend Frëngu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, i cili plotëson kushtet ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele.
2. Caktimin me short të zotit Bujar Sheshi si relator për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë shpallur me vendimin Nr.299, datë 10.11.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 19.12.2022.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza